

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGO
GLLOGOC MUNICIPALITY

PRANUAR

13 | 04 | 2023

Nj. Org.

Numër

Shtojca

Vlera

01-

400/01

17631



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna Drenas / Municipality Drenas
Zyra e Kryetarit



Komuna e Drenasit, në kuadër të zhvillimit të Bujqësisë, bazuar në Nenin 19 , pika 1.3 të rregullores Nr.12-320-19338 të dt. 07.04.2017 për Kushtet , Kriteret dhe Procedurat e Ndarjës së Subvencioneve, Rregullore për ndryshim dhe plotësim të rregullorës për ndarjën e subvencioneve me Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 si dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Worldwide- Zyra në Kosovë dhe Komuna e Drenasit me Nr. 01-400/01-9569 të dt 23.02.2023 , njofton të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojn për Projektin e poshtëshënuar :

THIRRJE PËR APLIKIM

Furnizimi me Makina Mbjellëse të Misrit

Kriteret që duhet plotësuar për aplikim:

1. Fermeri duhet të jetë banor i Komunës së Drenasit;
2. Të posedoj të paktën 3ha tokë të punueshme;
3. Të posedoj traktor;
4. Të jetë i gatshëm për participim ,
5. Në bazë të rregullores Nr.12-320-19338 të dt. 07.04.2017 neni 19, pika 2, rregullorës për ndryshim dhe plotësim për ndarjën e subvencioneve me nr 02-400/01-18380 të dt.27.04.2022 neni 17 - Përparësi në kushte të barabarta kanë :
 - ❖ Fermerët që nuk janë përfitues në tre vitet e fundit nga DBPZHR-ja;
 - ❖ Fermerët që nuk janë përfitues nga MBPZHR-ja dhe Donatorë të tjerë brenda vitit fiskal;
 - ❖ Të rinjët;
 - ❖ Gjinia Femrore;
 - ❖ Familjet që kanë persona me nevoja të veqanta, familjet e dëshmorëve, familjet që kanë persona të zhdukur gjatë luftës, invalidët e luftës, veteranët e luftës, viktimat civile të luftës, familjet qe kanë jetim;
 - ❖ Përsnat me gjendje të rënd ekonomike;
 - ❖ Fermerët të cilët jetojn në zona malore;
 - ❖ Fermerët që janë të regjistruar para thirrjes publike.

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

1. Aplikacioni i plotësuar;
2. Kopja e leternjoftimit të Republikës së Kosovës;
3. Numrin identifikues të fermerit (NIF);
4. Deklaratë për participim nga fermeri;
5. Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë;
6. Fleta poseduese e tokës që posedon (ne emër të aplikuesit ose familjarit të ngushtë e dëshmuar me vijën e gjakut);
7. Fleta poseduese e tokës e marr me qera (në emër të qiradhënësit apo e familjarit të ngushtë e dëshmuar me vijën e gjakut);
8. Kontratë e lidhur mes dy palëve për tokën e marrur me qera (të jetë së paku tre vjeçare)- (për fermerët që kanë toka me qera)
9. Dëshmi nese kanë persona me nevoja të veçanta, familjët e dëshmorëve, familjët që kanë persona të zhdukur gjatë luftës, invalidët e luftës, veteranët e luftës, viktimat civile të luftës, për gjendjen e rënd ekonomike, për fëmijet jetim.

Sqarim: kriter për të përfituar këtë mekanizëm bujqësor do të jetë vlerësimi në terren nga komisioni për gjendjen e fermës së aplikuesit (kushtet e mirëmbajtjes së fermës-puna në fermë si dhe do të merrën parasysh edhe aplikimi për pagesa direkte-subvencione ne tre vite e fundit).

Afati i aplikimit nga data 14/04/2023 deri 09/05/2023

Drenas 2023



Kryetari i Komunës

Ramiz Eladrovci